

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sulmet ruse vrasin 11 persona dhe plagosin dhjetëra të tjerë gjatë 24 orëve të fundit në Ukrainë - Eurone ws Albania
ADRESA	https://euronews.al/sulmet-ruse-vrasin-11-persona-dhe-plagosin-dhjetera-te-tjere-gjate-24-oreve-te-fundit-ne-ukraine/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 11:33:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 11:30:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	32e4d0d0cbd200f4f9f947b02ab835d20289a1b48ef1096afe4b86f385d928e7
TEKSTI	3003d08e567d7a81ff92a642bef2ee9b02a07def004478c580ddda057429d085
PAMJA	22ca6ba4fcefff3ff5d5e9978951f1577b3a93d35f9793df079c05d1bef45a90

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e3714cd27509e5d3abfc7f6898af1d35acadde0797df2629a567588fd807e3c9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d62161966812e333892ed1a12b4b718f8d0962907bcb93c104eb3485a382e6f9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e3714cd27509e5d3abfc7f6898af1d35acadde0797df2629a567588fd807e3c9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Lufta në Ukrainë Gjyqi i UÇK Krim në familje Lufta në Iran

BOTA

Sulmet ruse vrasin 11 persona dhe plagosin dhjetëra të tjerë gjatë 24 orëve të fundit në Ukrainë

19 Shtator 2026 | 13:30

Sulmet ajrore ruse në Ukrainë vranë të paktën 11 persona dhe plagosën dhjetëra të tjerë gjatë ditës së kaluar, sipas autoriteteve lokale.

Në Oblastin e Kharkivit në Ukrainën verilindore, pesë persona u vranë dhe 15 u plagosën në sulmet ruse, raportoi guvernatori Oleh Syniehubov, duke shtuar se forcat ruse kishin qëlluar dy raketa, pesë bomba ajrore të drejtuara dhe pothuajse 60 dronë në objektiva në të gjithë rajonin.

Raportohet se sulmet goditën fshatrat Lypkuvativka, Velyki Burluk dhe Slatyne, si dhe qytetet e Kharkiv dhe Balakliia, ndër të tjera.

Dy persona u vranë gjithashtu dhe pesë u plagosën pas një vale sulmesh me dronë, sulmesh ajrore dhe granatimesh artilerie në të gjithë rajonin Kherson të Ukrainës jugore, sipas Administratës Shtetërore Rajonale të Khersonit.

“Trupat ruse goditën infrastrukturën kritike, si dhe lagjet rezidenciale në vendbanimet e rajonit, duke dëmtuar, në veçanti, pesë ndërtesa të larta dhe shtatë shtëpi private”, tha ajo në një deklaratë të postuar në Telegram.

Në Donetsk, në lindje të vendit, një person u vra në qytetin e Kramatorskut, ndërsa 13 persona u plagosën në të gjithë rajonin.

Një burrë 51-vjeçar dhe një grua 45-vjeçare u vranë gjithashtu pasi një raketë e drejtuar goditi një ndërtesë të lartë në Sumy Oblast në veri, thanë autoritetet. Një burrë 32-vjeçar vdiq gjithashtu pas një sulmi me dron në rajon.

Administrata Ushtarake Rajonale e Sumy-t raportoi 50 sulme ndaj 21 vendbanimeve nga e premnja deri të shtunën në mëngjes, me forcat ruse që thuhet se kanë lëshuar dronë, mortaja, artileri dhe bomba ajrore të drejtuara.

Kjo vjen ndërsa forcat ajrore ukrainase raportuan se Rusia kishte qëlluar dy raketa “Zircon” nga rajoni i saj Kursk, si dhe 174 dronë drejt Ukrainës gjatë natës.

“Sipas të dhënave paraprake, që nga ora 8 e mëngjesit, forcat e mbrojtjes ajrore kanë rrëzuar ose neutralizuar 141 objektiva”, tha forca, duke shtuar se sulme ishin regjistruar në 15 lokacione.

LAJMI I FUNDIT

13:19 U kap duke transportuar 7 emigrantë të paligjshëm, arrestohet 32-vjeçari, në kërkim bashkëpunëtori

13:08 Kryeministri Rama vizitë në SHBA, merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së

13:04 Trump nënshkruan ligjin për sanksione gjithëpërfshirëse ndaj Rusisë, synohet goditja e ekonomisë dhe “flota në hije”

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

13:00 Vrau gruan me thikë në Tiranë, kapet autori pas disa orë kërkimesh në Kamëz

12:57 Maran e la jashtë listës së Kombëtares, reagon Jasir Asani

12:52 SHBA miraton paketën ushtarake prej 2.68 miliardë dollarësh për Ukrainën

TESTIM

Të shtunën, Komanda Operacionale e Forcave të Armatosura të Polonisë tha se kishte aktivizuar masat e mbrojtjes ajrore dhe kishte ngritur në ajër avionë ushtarakë në përgjigje të sulmeve me dronë rusë ndaj Ukrainës.

“Këto masa janë parandaluese në natyrë dhe synojnë sigurimin dhe mbrojtjen e hapësirës ajrore polake, veçanërisht në rajonet ngjitur me zonat e kërcënuara”, tha ajo në një deklaratë.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA
Trump nënshkruan ligjin për sanksione gjithëpërfshirëse ndaj Rusisë, synohet goditja e ekonomisë dhe “flota në hije”
Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, nënshkroi të premten një ligj për një paketë gjithëpërfshirëse sanksionesh që synojnë zyrtarët rusë dhe shtyllat kryesore të ekonomisë së...

13:04 | 19/09/2026

BOTA
SHBA miraton paketën ushtarake prej 2.68 miliardë dollarësh për Ukrainën
Departamenti i Shtetit tha të premten se SHBA-të miratuan një shitje të mundshme prej 2.68 miliardë dollarësh të pajisjeve ushtarake të huaja për Ukrainën, për...

12:52 | 19/09/2026

BOTA
Pakti me SHBA-në, Danimarka: Groenlanda nuk heq dorë nga sovraniteti i saj pas marrëveshjes
Danimarka mirëpriti sot marrëveshjen të shpallur nga Donald Trump, e cila, siç tha presidenti amerikan, i jep Uashingtonit “kontroll të përhershëm” mbi sigurinë e Groenlandës...

12:44 | 19/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakti

Follow Euronews on all platforms: